



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në Prizren / Osnovno Tužilaštvo Prizren / Basic Prosecution in Prizren

AD.nr. 8/24

Prizren, Dt. 05.08.2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e qytetarit [REDACTED] nga [REDACTED] rruga [REDACTED], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, [REDACTED], në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores nr. 05.2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar dhe joserioze ankesa e qytetarit [REDACTED] nga [REDACTED] rruga [REDACTED], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, [REDACTED], sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

A r s y e t i m


Me datë 02.08.2024, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ka pranuar një parashtrësë (akt përcjellës) nga Zyra e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me nr. [REDACTED] të datës 02.08.2024, lidhur me ankesën e qytetarit [REDACTED] nga [REDACTED] rruga [REDACTED].

Ankesa në fjalë është e pa bazuar dhe jo serioze, nuk mund të konstatohet asnjë veprim apo shkelje konkrete e prokurorit [REDACTED]. Ankesa në fjalë nuk është e bazuar në asnjë fakt apo provë, është jo serioze, ku ankuesi pretendon apo përfshinë situata të ndryshme pa një lidhje të ngjarjeve mes tyre, ku më tepër shpreh pakënaqësinë dhe pretendon se disa prona të paluajtshme janë pronë e tij. Aktakuza [REDACTED], e datës 21.02.2023, është ngritur nga prokurori [REDACTED] ndaj të pandehurve [REDACTED] etj., për shkak të veprës penale, sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402, paragrafi 4, lidhur me par.2 dhe 1, e lidhur me nenin 31, të KPRK-së. Kjo aktakuzë nuk ka të bëjë fare me pronat e paluajtshme për të cilat pretendon ankuesi.

Andaj, kryeprokurori si autoritet kompetent, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesave të lartcekura, deklaratës së prokurorit dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar dhe vendosur se ankesa është e pabazuar dhe joserioze, sepse në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të lëndës nuk ka mundur të gjejë ndonjë provë apo fakt që vërteton pretendimet e ankuesit.

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.

KRYEPROKURORI

[REDACTED]


T'i dorëzohet:

- *Këshillit Prokurorial të Kosovës*
- [REDACTED] nga [REDACTED]
- *Arkivë*